

**FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS
OPERACIONET**

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË FKPK OPERACIONEVE	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-26

Raporti i auditorit të pavarur

Për Bordin Menaxhues dhe Menaxhmentin e
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës – Operacionet (“FKPKOP”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2025, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka mbaruar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të FKPKOP-së më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën financiare të tij dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me SNRF-të, standardet e kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”). Përgjegjësitë tona nën keto standarde janë të sqaruara më tej në seksionin e Përgjegjësisë të Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga FKPKOP në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Informacioni tjetër në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshijnë informacionin e përfshirë në raportin vjetor, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi to. Raporti vjetor pritet të na bëhet i disponueshëm pas datës së këtij raporti të auditorit.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk përfshin informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim dhe nuk do të shprehim asnjë lloj konkluzioni të sigurisë mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër, të identifikuar më lart kur ai të bëhet i disponueshëm dhe, duke bërë këtë, të marrim parasysh nëse informacioni tjetër është në kundërshtim të rëndësishëm me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose ndryshe duket të jetë gabim material. Kur të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar ta komunikojmë këtë çështje te ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe ata që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të standardet e kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë më vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojnë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të FKPKOP.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë arritimë një siguri të arsyeshme për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare si një tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i realizuar në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë një gabim material kur ai ekziston. Gabimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen të materializuara nëse, individualisht ose në përmbledhje, mund të pritet arsyeshëm që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marrë në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidencat të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të FKPK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që FKPK mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të terheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që FKPK të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, përpos të tjerave, lidhur me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtina,
29 prill 2026


Suzana Stavrić
Auditor Ligjor



	Shënimet	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
		EUR	EUR
Mjetet			
<i>Mjetet qarkulluese</i>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	4	901,004	608,717
Afatizimet bankare	5	6,419,318	997,251
Llogaritë e arkëtueshme dhe parapagimet	6	793,263	750,416
		8,113,585	2,356,384
<i>Mjetet joqarkulluese</i>			
Afatizimet bankare	5	3,025,633	6,250,651
Pronat dhe pajisjet	9	715,956	628,842
Pasuritë me të drejtë të përdorimit	10	686,315	160,452
Mjetet e patrupëzuara	11	69,266	80,302
		4,497,170	7,120,247
Gjithsej mjetet		12,610,755	9,476,631
Detyrimet			
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	12	2,654,571	824,546
Detyrimet e qirasë	10	138,263	59,122
		2,792,834	883,668
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Detyrimet e qirasë	10	548,052	116,455
		548,052	116,455
Gjithsej detyrimet		3,340,886	1,000,123
Mjetet neto të FKPK Operacioneve		9,269,869	8,476,508

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së më 28 shkurt 2026, dhe nënshkruar në emrin e tyre nga:

		
Z. Emanuel Bajra Kryesues i Bordit Drejtues	Z. Adrian Zalli Drejtor Menaxhues	Z. Vërshim Hatipi Drejtor për Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
		EUR	EUR
Të hyrat			
Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	13	11,842,713	10,567,254
Të hyrat tjera	14	492,405	430,036
Gjithsej të hyrat		12,335,118	10,997,290
Shpenzimet			
<i>Shpenzimet e investimeve</i>			
Tarifat neto të fondeve të hapura investuese	15	(6,456,198)	(5,268,668)
Brokerët, kujdestarët dhe shpenzimet e tjera investuese	16	(487,385)	(391,487)
Gjithsej shpenzimet e investimeve		(6,943,583)	(5,660,155)
<i>Shpenzimet Operacionale</i>			
Kostoja e stafit	17	(925,200)	(769,812)
Shpenzimet për Bordin Drejtues	18	(204,941)	(96,053)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9-11	(174,591)	(105,332)
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondencat tjera		(109,433)	(116,166)
Shpenzimet e tjera operacionale	19	(174,454)	(146,054)
Gjithsej shpenzimet operacionale		(1,588,619)	(1,233,417)
Gjithsej shpenzimet		(8,532,202)	(6,893,572)
Humbjet neto nga provizionet e mjeteve financiare	5	(9,555)	(6,267)
Suficiti neto për vitin		3,793,361	4,097,451

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Suficiti	Rezervat	Gjithsej
		EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2024		1,879,057	6,000,000	7,879,057
Suficiti neto për vitin		4,097,451	-	4,097,451
Kthimet tek mjetet pensionale (FKPKMP)	20	(3,500,000)	-	(3,500,000)
Më 31 dhjetor 2024		2,476,508	6,000,000	8,476,508
Suficiti neto për vitin		3,793,361	-	3,793,361
Kthimet tek mjetet pensionale (FKPKMP)	20	(3,000,000)	-	(3,000,000)
Transferimet	20	(1,000,000)	1,000,000	-
Më 31 dhjetor 2025		2,269,869	7,000,000	9,269,869

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 EUR	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 EUR
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale			
Suficiti neto për vitin		3,793,361	4,097,451
Rregullimet për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	9-11	174,591	105,332
Interesi dhe të hyra të tjera jo-monetare	14	(360,188)	(270,772)
Interesi i qirasë	10	24,795	10,382
Humbjet neto nga provizionet e mjeteve financiare	5	9,555	6,267
		3,642,114	3,948,660
Interesi i arkëtuar		131,449	233,530
		3,773,563	4,182,190
Ndryshimet në mjetet dhe detyrimet operacionale:			
(Zvogëlimi) / Rritja në llogaritë e pagueshme dhe akruale		(169,975)	174,226
Rritja në llogaritë e arkëtueshme dhe parapagimet përjashtuar interesin e arkëtueshëm		(43,966)	(100,348)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale		3,559,622	4,256,068
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronave dhe pajisjeve	9	(115,235)	(36,042)
Blerja e mjeteve të patrupëzuara	11	(23,944)	(11,876)
Pagesat për investim në afatizime bankare	5	(3,000,000)	(9,400,000)
Të hyrat nga maturimi i afatizimeve bankare (kryegjëja)	5	1,000,000	9,000,000
Rrjedhja neto e parasë e përdorur në aktivitetet investuese		(2,139,179)	(447,918)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesat e qirasë	10	(128,156)	(62,697)
Kthyer tek mjetet pensionale (FKPKMP)	20	(1,000,000)	(3,500,000)
Rrjedhja neto e parasë e përdorur në aktivitetet financuese		(1,128,156)	(3,562,697)
Neto rritja në paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj		292,287	245,453
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		608,717	363,264
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit		901,004	608,717

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e shfuqizuar nga Rregullorja 2005/20, kjo më vonë e shfuqizuar nga Ligji Nr. 03/L-084 i Republikës së Kosovës, edhe kjo më vonë e shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplementuar me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-168, Nr. 05/L-116 dhe Nr. 07/L-016; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). FKPK-ja mirëmban llogaritë individuale për secilin pjesëmarrës, në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga anëtarët ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 04/L-101, një anëtar pa të drejtë vote do t'i përfaqësojë interesat e Qeverisë. Gjatë vitit 2025 dhe 2024, Bordi Drejtues ka vepruar pa anëtarin pa të drejtë vote i cili e përfaqëson Qeverinë. Nga janari deri në dhjetor 2024 FKPK-ja ka vepruar me vetëm pesë anëtarë të Bordit Drejtues, të emëruar nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2023, mjaftueshëm për të pasur kuorum. Dy anëtarë shtesë me të drejtë vote u emëruan në dhjetor 2024.

Këto pasqyra financiare janë për FKPK Operacionet (ose "FKPKOP") i cili është subjekti i menaxhimit dhe administrimit të kursimeve pensionale të kontribuuesve (mjeteve pensionale). Pasqyrat financiare për FKPK Mjetet Pensionale (ose "FKPKMP"), janë përgatitur ndaras nga pasqyrat financiare të FKPKOP.

Drejtori dhe 39 punonjës i menaxhuan operacionet ditore të FKPK-së gjatë vitit 2025 (2024: Drejtori dhe 34 punonjës).

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të FKPKOP janë përgatitur në përputhje me standardet e kontabilitetit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet mbi to të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas konventës së kostos historike. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit të SNRF-së kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabël. Po ashtu kërkohet që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të FKPK-së. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë domethënëse për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 3.13 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur më datë, dhe për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2025 dhe 2024. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në euro, përveç ku është theksuar ndryshe. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshatjes me prezantimin e vitit aktual.

Prezantimi i pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime të qartësisë, pasqyrat financiare dhe shënimet e pasqyrave financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare.

Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime.

Vijimësia

Menaxhmenti i FKPK-së ka bërë një vlerësim të aftësisë së FKPK-së për të vijuar dhe është i opinionit që ka burime për të vazhduar aktivitetet në të ardhmen. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të ngrejë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë për të vijuar. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e vijimësisë.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

i) Aplikimi fillestar i standardit të ri si dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën aktuale të raportimit

Ndryshimet në vijim në standardet ekzistuese, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, hynë në fuqi për periudhën aktuale:

- **Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025.

Implementimi i të mësipërmeve nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat financiare të FKPKOP.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (vazhdim)

ii) Standardet e reja si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara që ende nuk janë përvetësuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, janë publikuar por ende nuk ishin obligative për periudhën raportuese vjetore 31 dhjetor 2025:

- **Ndryshimet në SNRF 1 "Adoptimi i parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shpalosjet" dhe SNRF 9 "Instrumentet financiare" dhe SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së parasë"** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026.
- **SNRF 18 Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027.
- **SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalosjet** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027.
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjet të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar).

FKPKOP ka zgjedhur të mos përvetësojë këto standarde, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime përpara se ato të hyjnë në fuqi. FKPKOP parashikon që përvetësimi i këtyre standardeve dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPKOP në periudhën e zbatimit fillestar.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL

FKPKOP në mënyrë konsistente ka zbatuar politikat kontabël në vijim ndaj të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse thuhet ndryshe.

3.1 Instrumentet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj, afatizimet bankare, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet.

Njohja fillestare dhe matja

Asetet dhe detyrimet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të FKPKOP kur e njëjta bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit ose në datën në të cilën ato burojnë.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare (përveç aseteve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aseteve ose detyrimeve financiare sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aseteve financiare ose detyrimeve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

Të gjitha shitblerjet në mënyrë të rregullt të aseteve financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtimit.

Kompensimi

Asetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston e drejta e zbatueshme ligjërish për kompensim të shumave të njohura dhe ka qëllim për shlyerje mbi bazën neto.

Klasifikimi dhe matja e aseteve financiare dhe detyrimeve financiare

Sipas SNRF 9, asetet klasifikohen në bazë të modelit të biznesit të adoptuar për administrimin e aseteve dhe në karakteristikat e tyre kontraktuale të fluksit monetar në një nga kategoritë e mëposhtme të matjes:

- Kosto e amortizuar (AMC);
- Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAT); ose
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Asetet financiare maten me AMC nëse mbahen brenda një modeli biznesi për qëllimin e mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale (mbaj për të arkëtuar) dhe nëse flukset monetare janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e mbetur të kryegjësë. Në përgjithësi, ky është rasti për portofolin e aseteve financiare të FKPKOP.

FKPKOP nuk ka asete financiare që maten në VDAT dhe/ose VDFH.

Në përgjithësi, detyrimet financiare maten me kosto të amortizuar.

Testi VPKI (vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e mbetur të kryegjësë)

Hapi i dytë në klasifikimin e aseteve financiare në portofol që "mbahen për të arkëtuar" lidhet me vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me testin VPKI. Shuma e kryegjësë pasqyron vlerën e drejtë në njohjen fillestare minus çdo ndryshim të mëvonshëm, p.sh. për shkak të shlyerjes. Interesi duhet të përfaqësojë vetëm konsideratë për vlerën në kohë të parasë, riskun kreditor, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe një marzh fitimi në përputhje me tiparet bazë të huadhënies. Nëse flukset monetare sjellin më shumë se ekspozim të papërfillshëm ndaj rrezikut ose luhatshmërisë që nuk është në përputhje me tiparet bazë të huadhënies, asetit financiar njihet detyrimisht në VDFH.

Në përgjithësi, portofolet e aseteve financiare të FKPKOP që "mbahen për të arkëtuar" kanë flukse monetare kontraktuale që janë në përputhje me testin VPKI.

Dëmtimet

FKPKOP mbi bazën e parashikimit vlerëson humbjet e pritshme kreditore (HPK) të lidhura me asetet e instrumenteve të borxhit të matura me kosto të amortizuar. FKPKOP në çdo datë raportimi njih një provizion për humbjet e tilla. Matja e HPK pasqyron:

- Një vlerë të paanshme me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme;
- Vlerën kohore të parasë; dhe
- Informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të tepërta në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

3.1 Instrumentet financiare (vazhdim)

Ç'regjistrimi

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga aseti kanë skaduar, ose kur ato janë transferuar dhe, ose (a) FKPPOP transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, ose (b) FKPPOP as nuk transferon dhe as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe FKPPOP nuk e ka mbajtur kontrollin.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur aty shlyhen (pra, kur obligimi i theksuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose ka skaduar).

3.2 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre ose më pak muajsh.

3.3 Klasifikimi si qarkullues ose jo-qarkullues

Asetet dhe detyrimet paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin si qarkullues dhe jo-qarkullues. Një aset klasifikohet si qarkullues kur: ose pritet të realizohet ose synohet të shitet ose konsumohet në ciklin normal të funksionimit; mbahet kryesisht për qëllime tregtimi; pritet të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose aseti është para e gatshme ose ekuivalent i parasë së gatshme, përveç rasteve kur kufizohet nga shkëmbimi ose përdorimi për të shlyer një detyrim për të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit. Të gjitha asetet e tjera klasifikohen si jo-qarkulluese.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritet të shlyhet në ciklin normal të funksionimit; mbahet kryesisht për qëllime tregtimi; duhet të shlyhet brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet e tjera klasifikohen si afatgjata.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Pronat dhe pajisjet dhe qiramarrjet

3.4.1 Prona dhe pajisjet

Pronat dhe pajisjet e operacioneve të FKPKOP përbëhen nga: Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme; mobilie, instalime dhe pajisje të ngjashme; pajisje të tjera të zyrës; dhe automjete; të cilët barten si kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimet nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin çmimin e blerjes dhe të gjitha kostot që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje operative për përdorimin e tij të synuar.

Ndërtimet në vijim raportohen me koston e ndërtimit përfshirë kostot e ngarkuara nga palët e treta. Pas përfundimit, të gjitha kostot e akumuluar të pasurive transferohen në kategorinë përkatëse të pronës dhe pajisjeve dhe më pas i nënshtrohen normave të aplikueshme të zhvlerësimit. Toka dhe ndërtimet në vijim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi ngarkohet në bazë të metodës drejtvizore përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të mjeteve, duke i përdorur normat si në vijim:

Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme	33%
Mobiliet, instalimet dhe pajisjet	20%
Pajisjet e tjera të zyrës	20%
Veturat	20%

Jeta e dobishme e pronave dhe pajisjeve, nëse është e nevojshme, shqyrtohet e përshtatet së paku në baza vjetore.

3.4.2 Qiramarrjet

Për çdo kontratë të re të lidhur me ose pas 1 janarit 2019, FKPKOP konsideron nëse është një kontratë, ose përmban një qira.

Matja dhe njohja e qirave

Në datën e fillimit të qirasë, FKPKOP njeh një pasuri me të drejtë të përdorimit dhe një detyrim të qirasë në bilancin e gjendjes. Pasuritë me të drejtë të përdorimit maten me kosto, e cila përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga FKPKOP, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe heqjen e pasurisë në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë e bërë para datës së fillimit të qirasë (duke minusuar çdo incentivë të pranuar).

FKPKOP zhvlerëson pasuritë me të drejtë të përdorimit sipas metodës drejtvizore nga data e fillimit të qirasë e deri te më e hershme: përfundimi i jetës së dobishme të pasurisë me të drejtë të përdorimit ose i afatit të qirasë. FKPKOP vlerëson gjithashtu pasurinë me të drejtë të përdorimit për dëmtime kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, FKPKOP mat detyrimin e qirasë në vlerën e tanishme të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, duke përdorur normën e interesit për huamarrjet e reja në datën e fillimit (norma e përshkallëzuar e huamarrjes). Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë ato substancialisht fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shumat që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet që arsyeshëm pritet të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet për pagesat e bëra dhe do të rritet për kamatë. Ajo rivlerësohet për të pasqyruar çdo rivlerësim ose modifikim, ose nëse ka ndryshime në pagesat substancialisht fikse. Kur detyrimi i qirasë rivlerësohet, përdoret norma e huamarrjes në kohën e rivlerësimit, dhe rregullimi përkatës pasqyrohet në pasurinë me të drejtë të përdorimit, ose në fitim dhe humbje nëse pasuria me të drejtë të përdorimit tashmë ka rënë në zero.

FKPKOP ka zgjedhur t'i llogarisë qira afatshkurtra dhe ato me vlerë të ulët duke përdorur qasje praktike. Në vend që të njihet një pasuri me të drejtë të përdorimit dhe detyrimi i qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si shpenzime në fitim ose humbje sipas metodës drejtvizore gjatë afatit të qirasë. Të dyja, pasuritë me të drejtë të përdorimit dhe detyrimet e qirasë, janë paraqitur si bilance të veçanta në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.5 Mjetet e patrupëzuara

Mjetet e patrupëzuara përbëhen nga softuerët e licencuar kompjuterik. Këto fillimisht paraqiten sipas koston dhe më pas sipas koston së tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga prishjet, nëse ka të tilla.

Amortizimi regjistrohë kur këto mjete janë të disponueshme për përdorim sipas metodës drejtvizore ku kostoja e mjetit të patrupëzuar shlyhet përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit, duke i përdorur normat si në vijim:

Softuerët - 20%

Licencat amortizohen sipas kohëzgjatjes së licencës deri në maksimum 5 vjet.

Jeta e dobishme e mjeteve të patrupëzuara rishikohet e përshtatet të paktën një herë në vit, nëse është e nevojshme.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Të hyrat

Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale

Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale përfshijnë tarifat për mbulimin e shpenzimeve që ndërlidhen me investimin e mjeteve pensionale (tarifat për aktivitetet investuese) dhe tarifat për mbulimin e shpenzimeve të tjera të FKPKOP që nuk ndërlidhen me investimin e mjeteve pensionale (tarifat për aktivitetet operacionale). Të dy tarifat miratohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168, pas kërkesës me shkrim të Bordit Drejtues. Tarifat ngelin në fuqi deri në ndryshimin e tyre nga Kuvendi.

Edhe tarifa investive edhe ajo operacionale ngarkohen ndaj bruto vlerën e mjeteve pensionale me normat përkatëse, duke ulur vlerën neto të mjeteve të pjesëmarrësve. Formula për llogaritjen ditore të tarifave përkatëse është:

Tarifa = [Mjetet bruto të pjesëmarrësve] * [Norma e Tarifës] / [Numri i ditëve kalendarike në vit].

Tarifat bëhen të arkëtueshme dhe pranohen pas përfundimit të muajit.

Të ardhurat nga interesi

Interesi njihet në një bazë proporcionale kohore duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi përfshijnë interesin nga depozitat me afat, paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj.

3.7 Shpenzimet e investimeve

Tarifat neto të fondeve të hapura investuese

Tarifat neto të fondeve të hapura investuese përfshijnë tarifat e ngarkuara nga fondet e hapura dhe ato të tregtueshme në bursa për menaxhimin e mjeteve pensionale, heq zbritjet që ato mund t'i ofrojnë ose jo. Tarifat njihen në baza ditore bazuar në prospektin e fondit ose në marrëveshje të veçantë nëse ka. Tarifat mund të ndalen direkt nga fondi, duke ulur kështu vlerën neto të mjeteve, ose mund të faturohen, me ç'rast ato paguhen pas përfundimit të periudhës.

Tarifat e brokerëve

FKPKOP paguan komisione dhe tarifa të ndryshme për të gjitha blerjet dhe shitjet e investimeve të mjeteve pensionale të vendosura përmes brokerëve ndërmjetësues. Kostot e tilla njihen menjëherë si shpenzime.

Tarifat e kujdestarëve

FKPKOP paguan tarifa për shërbimet e kujdestarisë, të cilat përfshijnë ruajtjen e letrave me vlerë të blera dhe përpunimin e të ardhurave nga dividendët dhe pagesat e interesit, si përqindje e cila bazohet në vlerën e mjeteve në ruajtje. Këto tarifa njihen çdo tremujor gjatë periudhës. Këto tarifa bëhen të pagueshme dhe paguhen pas përfundimit të tremujorit.

Shpenzimet e tjera investuese

Shpenzime të tjera investuese përfshijnë kostot e abonimit në terminalet profesionale (për analizë investimesh, kuotim të çmimeve, marrje informatash nga tregjet), dhe shpenzime tjera që lidhen me aktivitetin e investimit të mjeteve pensionale.

3.8 Kostoja e pensionit

FKPKOP nuk mban provizione e as nuk ka kurrfarë obligimi ndaj pensioneve të të punësuarve, përtej kontributeve të paguara në skemën e lartpërmendur të pensioneve.

3.9 Tatimi

FKPK-ja si fond i mirëbesimit është i liruar nga tatimi në fitim i korporatave.

3.10 Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale njihen në fitim ose humbje me rastin e shfrytëzimit të shërbimit ose kur ndodhin.

3.11 Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga anëtarët e Bordit Drejtues të FKPK-së, që së bashku me entitetet të cilat ata i kontrollojnë, mund të ushtrojnë ndikim domethënës mbi operacionet dhe menaxhimin e FKPK-së. Gjatë shqyrtimit të secilës marrëdhënie të mundshme të palëve të ndërlidhura, vëmendja i drejtohet përmbajtjes së marrëdhënies, dhe jo thjesht formës juridike.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Zotimet dhe kontigjencat

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç kur mundësia e daljes së burimeve që mishërojnë përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Shuma e një humbjeje kontigjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë që, mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që rezulton nga një detyrim i lindur deri më datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

3.13 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Menaxhmenti gjithashtu duhet të ushtrojë gjykim në zbatimin e politikave kontabël të FKPKOP. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme.

Ky shënim shpalosë fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit dhe kompleksitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit që kanë një rrezik të theksueshëm për të rezultuar në përshtatje materiale gjatë vitit të ardhshëm financiar. Informata të hollësishme për secilën nga këto vlerësime dhe gjykime përfshihen në shënimet përkatëse së bashku me informacionin në lidhje me bazën e llogaritjes për çdo element të linjës së prekur në pasqyrat financiare.

Norma e përshkallëzuar e huamarrjes

Norma bazohet në atë që FKPKOP vlerëson se do të duhej t'i paguante një pale të tretë për t'i huazuar fondet e nevojshme për sigurimin e një asemi me vlerë të ngjashme me asetin me të drejtë përdorimi, me kushte, siguri dhe mjedis ekonomik të ngjashëm.

Jeta e dobishme e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit

Menaxhmenti e ka rishikuar jetëgjatësinë e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit më 31 dhjetor 2025. Menaxhmenti ka vlerësuar se jetëgjatësia e pasurive përfaqëson dobishmërinë e pritshme të tyre. Vlerat bartëse të pasurive të tilla janë analizuar në Shënimet 9 dhe 11. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërsimit teknologjik.

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore për asetet financiare të matura me koston e amortizuar është një sferë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të theksueshme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë (p.sh. gjasat e mospagesës së Thesarit të Kosovë dhe humbjet që rezultojnë). Shpjegimi i këtyre inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit të përdorura në matjen e HPK është detajuar më tej në Shënimin 3.15.5, i cili gjithashtu përcakton ndjeshmëritë kyçe të HPK ndaj ndryshimeve në këto elemente.

Disa gjykime të rëndësishme gjithashtu janë të nevojshme për zbatimin e kërkesave të kontabilitetit për matjen e HPK, si:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë;
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e HPK;
- Vendosja e numrit të peshave relative të skenarëve parashikues për çdo lloj produkti / tregu dhe HPK-në përkatëse; dhe
- Krijimi i grupeve të asetëve të ngjashme financiare për qëllime të matjes së HPK.

3.14 Rezerva

Rezerva operationale është pjesë e mjeteve neto të FKPKOP. Gjatë vitit, Bordi Drejtues ka vendosur të rrisë vlerën maksimale të rezervës në 10,000,000 EUR, dhe të transferojë në të 1,000,000 EUR shtesë. Bilanci i rezervës në datën e raportimit arriti në 7,000,000 EUR (2024: e kufizuar dhe e mbushur plotësisht në 6,000,000 EUR). Fondet e rezervës mund të përdoren vetëm me vendimin e Bordit Drejtues në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme, rrethanave të paparashikueshme, ose për blerjen e pasurive të paluajtshme për qëllime të operationeve të FKPK-së (siç janë zyrat).

Në rastet kur fondet nga rezerva përdoren për t'i mbuluar kostot e periudhës raportuese, shuma përkatëse lirohet nga rezerva operationale dhe regjistrohet drejtpërdrejt në pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto.

3 **POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**

3.15 **Menaxhimi i riskut financiar**

3.15.1 **Risku i tregjeve**

Risku i tregjeve vjen nga ndryshimet në çmimet e tregjeve, për shembull normat e këmbimit valutor dhe normat e interesit do të ndikojnë të hyrat e FKPKOP ose vlerën e instrumenteve financiare në posedim të tij. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregjeve është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregjeve përbrenda parametrevë të pranueshëm, duke optimizuar kthimet.

Risku i këmbimit valutor

Mjetet dhe detyrimet e FKPKOP nuk janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve në normat e këmbimit valutor meqë të gjitha transaksionet dhe bilancet janë në valutën vendore.

Risku i normave të interesit

Risku i normave të interesit vjen nga vlera reale ose vlera e rrjedhave të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Menaxhmenti i FKPKOP kryesisht është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit neto të riskut të normave të interesit, dhe vendos kufijtë për të reduktuar potencialin e mospërputhjes së normave të interesit.

Në datat e raportimit të gjitha asetet e FKPKOP që bartnin interes (afatizimet bankare) kishin kamatë fikse të interesit.

3.15.2 **Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që FKPKOP do të hasë në vështirësi për t'i kryer obligimet që lidhen me detyrimet financiare të cilat shlyhen përmes parasë së gatshme ose asetëve tjera financiare. Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, qasjen në fonde përmes mekanizmave adekuatë për kredi, si dhe aftësisë për të arkëtuar në kohë - sipas kushteve të paracaktuara - shumat e pritshme nga palët e treta. Duke pasur parasysh natyrën afatshkurtër të asetëve, si dhe arkëtimet stabile nga FKPKMP, menaxhmenti rishikon kërkesat për rrjedhën e parasë në baza tremujore për 3-6 muajt e ardhshëm.

Tabela në vijim paraqet maturimet e mbetura kontraktuale të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPKOP. Tabela është përpiluar në bazë të rrjedhjes së pa skontuar të parasë.

	Më 31 dhjetor 2025			Më 31 dhjetor 2024		
	1-6 muaj	6-12 muaj	12-60 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	12-60 muaj
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare						
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	901,004	-	-	608,717	-	-
Afatizimet bankare	2,074,803	4,344,515	3,025,633	-	997,251	6,250,651
Llogaritë e arkëtueshme	787,302	-	-	749,374	-	-
	3,763,109	4,344,515	3,025,633	1,358,091	997,251	6,250,651
Detyrimet financiare						
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	2,654,571	-	-	824,546	-	-
Detyrimet e qirasë (shih shënimin 10)	89,400	89,400	610,900	33,656	33,656	118,800
	2,743,971	89,400	610,900	858,202	33,656	118,800
Hendeku i maturimit	1,019,138	4,255,115	2,414,733	499,889	963,595	6,131,851

3 **POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**

3.15 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.15.3 Matja e vlerës së drejtë

Mjetet dhe detyrimet financiare grupohen në tre nivele hierarkike të vlerës së drejtë të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për asete dhe detyrime identike;
- Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, përjashtuar çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë në dispozicion për observim të aseteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (si çmime) ose indirekt (të përbëra nga çmimet); dhe
- Niveli 3: shënimet hyrëse për asetet e detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Në datën e raportimit, nuk kishte instrumente financiare të FKPKOP të matura sipas vlerës së drejtë.

Vlera kontabël e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj, depozitave me afat, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tyre të drejtë për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e detyrimeve të qirasë vlerësohet duke skontuar pagesat e ardhshme të qirasë me normën e përshkallëzuar të huamarrjes.

Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato asete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025 dhe 2024.

	Niveli	Më 31 dhjetor 2025		Më 31 dhjetor 2024	
		Vlera bartëse	Vlera e drejtë	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
		EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	2	901,004	901,004	608,717	608,717
Afatzimet bankare	2	9,444,951	9,481,676	7,247,902	7,275,071
Llogaritë e arkëtueshme	3	787,302	787,302	749,374	749,374
		11,133,257	11,169,982	8,605,993	8,633,162
Detyrimet financiare					
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	3	654,571	654,571	824,546	824,546
Detyrimet e qirasë	2	686,315	686,315	175,577	175,577
		1,340,886	1,340,886	1,000,123	1,000,123

3.15.4 Risku operacional

Risku operacional është risku i humbjes financiare të FKPKOP i shkaktuar nga procese, politika, sisteme me të meta ose të dështuara, ose ngjarje që pengojnë operimet e biznesit.

FKPK ka një zyrtar të riskut operacional, detyra e të cilit është të vlerësojë rreziqet kryesore në baza vjetore. Shumica e rreziqeve kryesore operacionale janë ulur ose nëpërmjet automatizimit të plotë (ose pothuajse të plotë) ose nëpërmjet përdorimit të parimi me 4 sy për autorizimin e ekzekutimit të proceseve të të dhënave, pagesave dhe transaksioneve të tjera.

3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

3.15 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.15.5 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPKOP nëse një klient ose palë tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale.

Analiza e riskut kreditor

Ekspozimi i FKPKOP ndaj riskut kreditor buron nga instrumentet në vijim:

- **Paraja në bankë** - Paraja në bankë përbëhet nga paratë në llogaritë rrjedhëse në bankat komerciale. Nuk ka vlerësim kreditor për shumicën e bankave komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës, megjithatë, për shkak të natyrës së tij afatshkurtër, risku kreditor nuk konsiderohet i theksuar dhe nuk llogariten humbjet nga dëmtimi.
- **Afatizimet bankare** - përbëhen nga depozitat me afat të investuara me bankat komerciale në Republikën e Kosovës. Më 31 dhjetor 2025, plasmanet e depozitave ishin me pesë banka, ku 25% ishin në njëri nga bankat (2024: tri banka, 42% në njëri nga bankat).

Humbjet e pritura kreditore (HPK)

Në çdo datë raportimi, FKPKOP mat provizionin e humbjeve në asetet financiare të matura me kosto të amortizuar me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë jetës së instrumentit, nëse risku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Nëse, në datën e raportimit, risku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, FKPKOP mat provizionin e humbjeve me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Vështirësitë e rëndësishme financiare të palës tjetër, probabiliteti që pala tjetër të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesat konsiderohen të gjithë tregues që vlerat mund të jenë të dëmtuara.

Një rritje e konsiderueshme e riskut kreditor përcaktohet nga menaxhmenti si çdo pagesë kontraktuale e cila ka më shumë se 30 ditë vonesë. Çdo pagesë kontraktuale e cila ka më shumë se 90 ditë vonesë konsiderohet kredi e dëmtuar.

Matja e HPK-së

Në vlerësimin e HPK-së, FKPKOP përdor shkallët e mospagesës të publikuara të emetuesve të të njëjtit rejting. Kur rejtingu nuk është i disponueshëm, përdoren shkallët e mospagesës për emetues të ngjashëm. Matja përshtatet për (a) kohëzgjatjen kur një instrument i caktuar ka më pak se një vit deri në maturim; (b) shkallët e rikuperimit për emetues të ngjashëm; dhe (c) faktorët e skontimit për normat e instrumenteve përkatëse.

Duke pasur parasysh inputet e mësipërme, të gjitha depozitat me afat janë klasifikuar si Fazë 1, me modelin e dëmtimit 12-mujor, dhe nuk pati lëvizje nëpër faza gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2025.

4 PARAJA E GATSHME DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Banka për Biznes – Llogari rrjedhëse	516,184	365,854
ProCredit Bank - Llogari rrjedhëse	256,603	194,659
NLB Bank – Llogari rrjedhëse	80,351	171
Banka Kombëtare Tregtare - Llogari rrjedhëse	39,411	39,660
Bankat e tjera vendore	8,172	7,901
Paraja në dorë	283	472
Gjithsej paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	901,004	608,717

5 AFATIZIMET BANKARE

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Afatizimet bankare para provizioneve për humbjet e pritshme kreditore	9,481,675	7,275,071
Provizionet për humbjet e pritshme kreditore	(36,724)	(27,169)
Afatizimet bankare	9,444,951	7,247,902

Më 31 dhjetor 2025 investimet e FKPKOP në depozitat me afat, të matura me koston e amortizuar, ishin me bankat në vend dhe janë përbërë nga 5 depozita me afat origjinal të maturimit 1-2 vjeçar, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 0.82 vitesh, dhe normë mesatare të interesit (të ponderuar) prej 4.05% (2024: 4 depozita me afat origjinal të maturimit 1-2 vjeçar, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare prej 1.32 vitesh, dhe normë mesatare të interesit prej 4.00%).

Në datën e raportimit, bilanci i depozitave me afat përbëhej nga 6,419,318 EUR për 3 depozita me maturim brenda 12 muajsh dhe 3,025,633 EUR për 2 depozita me maturim brenda 12 dhe 24 muajsh (2024: 997,251 EUR për 1 depozitë me maturim brenda 12 muajsh, dhe 6,250,651 EUR për 3 depozita me maturim brenda 12 dhe 24 muajsh).

Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme janë:

	2025	2024
	EUR	EUR
Më 1 janar	27,169	20,902
Shtesat e provizioneve për shkak të plasmaneve të reja dhe rivlerësimet	18,468	27,169
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit dhe rivlerësimet	(8,913)	(20,902)
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore	9,555	6,267
Më 31 dhjetor	36,724	27,169

Lëvizjet në afatizimet bankare dhe fletobligacione të Kosovës gjatë viteve ishin:

	2025	2024
	EUR	EUR
Më 1 janar	7,247,902	6,818,415
Plasmanet e reja	3,000,000	9,400,000
Interesi i fituar	326,804	258,353
Interesi i arkëtuar	(120,200)	(222,599)
Kryegjëja e maturuar	(1,000,000)	(9,000,000)
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore	(9,555)	(6,267)
Më 31 dhjetor	9,444,951	7,247,902

6 LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE PARAPAGIMET

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Llogaritë e arkëtueshme		
Të arkëtueshmet neto nga FKPMP	634,175	673,025
Rabatet dhe të arkëtueshmet e tjera	153,127	76,349
	787,302	749,374
Parapagimet	5,961	1,042
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme dhe parapagimet	793,263	750,416

Të arkëtueshmet neto nga FKPMP përbëhen nga tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve si dhe diferencën nga refondimet e kontributeve të gabuara të cilat u arkëtuan pas datës së raportimit. Rabatet e arkëtueshme përbëhen nga lirimet e ofruara nga fondet e hapura investuese të cilat nuk janë pranuar deri në datën e raportimit.

7 PASURITË DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, FKPMP nuk kishte as pasuri e as detyrime kontigjente.

8 ZOTIMET

Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, FKPMP nuk kishte zotime përtej detyrimeve për qira sipas politikës së shpalosur në Shënimin 3.4.2 "Qiratë".

9 PRONAT DHE PAJISJET

	Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme	Mobiliet instalimet dhe pajisjet	Pajisjet e tjera të zyrës	Veturat	Toka	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Kostoja						
Më 1 janar 2024	416,211	26,650	41,869	53,365	591,153	1,129,248
Shtesat gjatë vitit	30,317	-	5,725	-	-	36,042
Shlyerjet gjatë vitit	(41,705)	(576)	(11,691)	-	-	(53,972)
Më 31 dhjetor 2024	404,823	26,074	35,903	53,365	591,153	1,111,318
Shtesat gjatë vitit	85,583	20,817	8,835	-	-	115,235
Shlyerjet gjatë vitit	(9,168)	(4,570)	(12,031)	-	-	(25,769)
Më 31 dhjetor 2025	481,238	42,321	32,707	53,365	591,153	1,200,784
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2024	(400,090)	(23,446)	(38,796)	(53,365)	-	(515,697)
Ngarkesa gjatë vitit	(17,859)	(1,213)	(1,679)	-	-	(20,751)
Të eliminuara me shlyerje	41,705	576	11,691	-	-	53,972
Më 31 dhjetor 2024	(376,244)	(24,083)	(28,784)	(53,365)	-	(482,476)
Ngarkesa gjatë vitit	(21,832)	(2,918)	(3,371)	-	-	(28,121)
Të eliminuara me shlyerje	9,168	4,570	12,031	-	-	25,769
Më 31 dhjetor 2025	(388,908)	(22,431)	(20,124)	(53,365)	-	(484,828)
Vlera neto në libra						
Më 31 dhjetor 2025	92,330	19,890	12,583	-	591,153	715,956
Më 31 dhjetor 2024	28,579	1,991	7,119	-	591,153	628,842

Ndërtimet në vijim dhe avanset

Më 23 nëntor 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendimin nr. 06/117 për shpronësim në emër të interesit publik të pronës së ndërmarrjes shoqërore "P.SH. Shoqata SH.A.M. Vllaznim Union", me lokacion në ngastrën kadastrale, P-7207-0, në Lakërishtë, Zona Kadastrale e Prishtinës, Komuna e Prishtinës, për qëllime të përmbushjes së nevojave për akomodim të FKPK-së.

Sipas ligjeve të privatizimit në fuqi - duke qenë se shpronësimi ka ndodhur në interesin publik - FKPK-ja është dashur të paguajë vetëm 20% të vlerës së pasurisë në vlerë prej 249,012 EUR (vlerësuar nga një anketues i pavarur me vlerë prej 1,245,060 EUR), pretendimet e ligjshme të kreditorëve të pranuar si të tilla nga Autoriteti i Likuidimit në shumën 340,142 EUR, dhe tarifat administrative prej 2,000 EUR. Andaj, në qershor të vitit 2018, FKPK-ja i ka paguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit shumën e plotë të kërkuar prej 591,153 EUR.

Autoriteti i Likuidimit ka refuzuar kërkesa në shumën prej 133,618 EUR, ndërkohë që vendimet e tyre mund të apelohehen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Sipas marrëveshjes së shpronësimit, FKPK është zotuar dhe obligohet të paguajë çdo dhe të gjitha pretendimet e venduara në favor të ankuesve nga Dhoma e Posaçme, dhe shumat e tilla do të shtojnë koston e përfitimit të parcelës së shpronësuar.

Titulli i pronës i është transferuar FKPK-së në regjistrin kadastral gjatë vitit 2019. Në dhjetor 2024, Bordi Drejtues vendosi të tërheqë vendimin e mëparshëm për ndërtimin e selisë brenda perimetrit dhe vëllimit të ndërtesave ekzistuese. Kjo u bë për shkak se pritet rishikimi i planit rregullativ në atë zonë, që do të mundësonte ndërtimin e zyrave më të mëdha.

Gjatë viteve 2025 dhe 2024 FKPKOP ka shlyer vetëm asetet të zhvlerësuara plotësisht, të cilat janë hudhur.

Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, nuk kishte peng mbi asetet e FKPKOP.

10 PASURITË ME TË DREJTË TË PËRDORIMIT DHE DETYRIMET E QIRASË

	Pasuritë me të drejta të përdorimit
	EUR
Kostoja	
Më 1 janar 2024	482,767
Shtesat gjatë vitit	14,987
Më 31 dhjetor 2024	497,754
Shtesat gjatë vitit	769,201
Të tjetërsuara gjatë vitit	(451,296)
Më 31 dhjetor 2025	815,659
Zhvlerësimi i akumuluar	
Më 1 janar 2024	(283,840)
Ngarkesa gjatë vitit	(53,462)
Më 31 dhjetor 2024	(337,302)
Ngarkesa gjatë vitit	(111,490)
Të eliminuara me tjetërsim	319,448
Më 31 dhjetor 2025	(129,344)
Vlera neto në libra	
Më 31 dhjetor 2025	686,315
Më 31 dhjetor 2024	160,452

	Detymet e qirasë
	EUR
Më 1 janar 2024	212,905
Shtesat gjatë vitit	14,329
Interesat për vitit	11,040
Pagesat gjatë vitit	(62,697)
Më 31 dhjetor 2024	175,577
Shtesat gjatë vitit	760,502
Interesat për vitit	24,795
Të eliminuara me tjetërsim	(146,403)
Pagesat gjatë vitit	(128,156)
Më 31 dhjetor 2025	686,315

Më 31 dhjetor 2025, FKPKOP kishte vetëm një qiramarrje, për zyret e saj, të identifikuar si një pasuri me të drejtë të përdorimit në pasqyrën e pozicionit financiar (2024: dy qiramarrje). Detyrimet e qirasë të shoqëruar me të njëjtën tregohen po ashtu në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të dy qiratë, që ishin aktive në fillim të periudhës, u ndërprejnë parakohe me efekt nga data 30 qershor 2025. Norma e përshkallëzuar e huamarrjes e aplikuar mbi detyrimet e qirasë ishte 5.88%, me zhvlerësimin e pasurisë me të drejtë të përdorimit të bërë sipas metodës drejtvizore përgjatë jetëgjatësisë së qirasë.

Zyrat e reja qendrore janë marrë me qira nga 1 maji 2025, për një afat pesëvjeçar (deri më 30 prill 2030), pa mundësi të ndërprerjes së parakohshme. Norma e përshkallëzuar e huamarrjes, e aplikuar mbi detyrimet për qira në momentin e njohjes, ishte 5.69%, me amortizimin me të drejtë përdorimi është kryer me metodën drejtvizore gjatë jetëgjatësisë së qirasë. Në dhjetor 2025, qirasë iu shtua edhe një kat shtesë, me efekt nga 1 janari 2026, dhe në momentin e rivlerësimit u aplikua norma e përshkallëzuar e huamarrjes prej 6.87%.

Më 31 dhjetor 2025, detyrimet e skontuara të qirasë në vlerë prej 686,315 EUR janë përbërë nga 138,263 EUR si detyrime afatshkurta ndërkaq 548,052 EUR si detyrime afatgjata të qirasë. Detyrimet e pa skontuara të qirasë ishin në shumë 789,700 EUR nga të cilat 178,800 EUR ishin afatshkurtra ndërkaq 610,900 EUR afatgjata.

Më 31 dhjetor 2024, detyrimet e skontuara të qirasë në vlerë prej 175,577 EUR janë përbërë nga 59,122 EUR si detyrime afatshkurta ndërkaq 116,455 EUR si detyrime afatgjata të qirasë. Detyrimet e pa skontuara të qirasë ishin në shumë 186,112 EUR nga të cilat 67,312 EUR ishin afatshkurtra ndërkaq 118,800 EUR afatgjata.

11 MJETET E PATRUPËZUARA

	Softuerët dhe Licencat
	EUR
Kostoja	
Më 1 janar 2024	206,254
Shtesat gjatë vitit	11,876
Shlyerjet gjatë vitit	(78,897)
Më 31 dhjetor 2024	139,233
Shtesat gjatë vitit	23,944
Shlyerjet gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2025	163,177
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2024	(106,709)
Ngarkesa gjatë vitit	(31,119)
Të eliminuara me shlyerje	78,897
Më 31 dhjetor 2024	(58,931)
Ngarkesa gjatë vitit	(34,980)
Të eliminuara me shlyerje	-
Më 31 dhjetor 2025	(93,911)
Vlera neto në libra	
Më 31 dhjetor 2025	69,266
Më 31 dhjetor 2024	80,302

Gjatë vitit 2025 FKP KOP ka shlyer vetëm mjete të patrupëzuara të amortizuara plotësisht të cilat nuk mund të përdreshin më. Gjatë vitit 2024 FKP KOP nuk ka shlyer mjete të patrupëzuara.

12 LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
		EUR	EUR
Kthimet te mjetet pensionale (FKPKMP), të pagueshme	20	2,000,000	-
Të pagueshmet për aktivitetet investuese		530,219	707,047
Akralet për shtypje dhe dërgesë të pasqyrave individuale të llogarisë		83,589	79,975
Të pagueshmet dhe akralet e tjera		40,763	37,524
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe akralet		2,654,571	824,546

Më 31 dhjetor 2025 bilanci i të pagueshmeve për aktivitetet investuese përfshin tarifat menaxhuese të faturuara nga drejtuesit e fondeve të hapura në vlerë prej 470,843 EUR dhe shërbimet e terminalit investues në vlerë 59,376 EUR (2024: 676,543 EUR për tarifat menaxhuese të faturuara dhe 30,504 EUR për terminalin investues).

13 TARIFAT E NGARKUARA NDAJ MJETEVE PENSIONALE

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet investuese	10,238,657	9,150,415
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet operacionale	1,604,056	1,416,839
Gjithsej tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	11,842,713	10,567,254

Tarifat llogariten në baza ditore siç është shpalosur në Shënimin 3.6 të këtyre pasqyrave financiare. Tarifat e aplikueshme vjetore për periudhën e raportimit, siç janë miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168, ishin si në vijim:

Prej	Deri	Tarifa për aktivitetet investuese	Tarifa për aktivitetet operacionale	Gjithsej tarifat
1 janar 2024	31 dhjetor 2024	0.310% p.v.	0.048% p.v.	0.358% p.v.
1 janar 2025	31 dhjetor 2025	0.300% p.v.	0.047% p.v.	0.347% p.v.

14 TË HYRAT TJERA

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
<i>Aktivitetet operative</i>		
Të hyrat nga interesi vlerësuar me metodën e normës evective të interesit (në depozita dhe llogari rrjedhëse)	336,935	270,772
Përshtatja për diferencën nga refondimi i kontributeve	131,956	113,281
Të hyrat jo-monetare	23,253	-
Të hyrat tjera nga aktivitetet operacionale	24	-
	492,168	384,053
Të hyrat tjera nga aktivitetet investuese	237	45,983
Gjithsej të hyrat tjera	492,405	430,036

15 TARIFAT NETO TË FONDEVE TË HAPURA INVESTUESE

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Tarifat bruto	7,250,354	5,748,934
Rabatet	(794,156)	(480,266)
Tarifat neto të fondeve të hapura	6,456,198	5,268,668

Lista e detajuar e tarifave të ngarkuara dhe zbritjeve të dhëna nga fondet e hapura dhe fondet e tregtuara në bursë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë dhënë në Shënimin 6.c) të pasqyrave financiare të FPKKMP.

16 BROKERËT, KUJDESTARËT DHE SHPENZIMET E TJERA INVESTUESE

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Tarifat e brokerëve	161,188	125,959
Tarifat e kujdestarisë	226,534	159,312
Kostot e transfereve	70,317	79,465
Terminalet dhe shpenzimet e tjera	29,346	26,751
Gjithsej brokerët, kujdestarët dhe shpenzimet e tjera investuese	487,385	391,487

17 KOSTOJA E STAFIT

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Pagat e stafit	748,703	632,318
Kontributet pensionale të punëdhënësit	55,350	41,737
Kostoja e Kontratës Kolektive	103,568	79,522
Shpenzimet e tjera të stafit	17,579	16,235
Gjithsej kostoja e stafit	925,200	769,812

18 SHPENZIMET PËR BORDIN DREJTUES

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
	EUR	EUR
Kompensimi për anëtarët e Bordit	184,800	84,123
Kontributet pensionale të punëdhënësit	8,124	3,522
Takimet, udhëtimet dhe kostot e tjera	12,017	8,408
Gjithsej shpenzimet për Bordin Drejtues	204,941	96,053

19 SHPENZIMET E TJERA OPERACIONALE

		Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
		EUR	EUR
Interesi i qirasë	10	24,795	11,040
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët		24,307	14,186
Tarifa e BQK-së për mbikëqyrje		24,061	21,253
Auditimi i jashtëm		19,000	19,000
Shpenzimet për operim të zyrës		16,722	30,793
Komunikimi		14,451	6,714
Abonimi i softuerëve dhe mirëmbajtja		8,065	18,015
Edukimi publik dhe shpalljet		8,052	1,165
Trajnimet, udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit		7,504	14,788
Tarifat bankare		2,032	1,977
Shpenzimet e tjera		25,465	7,123
Gjithsej shpenzimet e tjera operationale		174,454	146,054

20 SUFICITI

	2025			2024		
	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Të hyrat për vitin						
Të hyrat nga tarifat	1,604,056	10,238,657	11,842,713	1,416,839	9,150,415	10,567,254
Të hyrat tjera	492,168	237	492,405	384,053	45,983	430,036
	2,096,224	10,238,894	12,335,118	1,800,892	9,196,398	10,997,290
Shpenzimet për vitin	(1,588,619)	(6,943,583)	(8,532,202)	(1,233,417)	(5,660,155)	(6,893,572)
Humbjet neto nga provizionet e mjetëve financiare	(9,555)	-	(9,555)	(6,267)	-	(6,267)
Neto suficiti për vitin	498,050	3,295,311	3,793,361	561,208	3,536,243	4,097,451
Suficiti në fillim të vitit	911,086	1,565,423	2,476,509	349,878	1,529,180	1,879,058
Paguar tek mjetet pensionale (FKPKMP)	-	(3,000,000)	(3,000,000)	-	(3,500,000)	(3,500,000)
Transferimet	(1,000,000)	-	(1,000,000)	-	-	-
Suficiti në fund të vitit	409,136	1,860,734	2,269,870	911,086	1,565,423	2,476,509

Gjatë vitit 2025 Bordi Drejtues vendosi t'i kthejë 3,000,000 EUR tek mjetet pensionale (FKPKMP) nga suficiti i aktivitetëve investuese. Bordi Drejtues vendosi gjithashtu, për shkak të mungesës së sigurimit fiduciar, të rrisë nivelin maksimal të rezervës nga 6,000,000 EUR në 10,000,000 EUR, dhe ta mbushë atë në nivelin prej 7,000,000 EUR për çfarë u bë një bartje prej 1,000,000 EUR nga suficiti i aktivitetëve operationale.

Gjatë vitit 2024, Bordi Drejtues ka vendosur t'i kthejë 3,500,000 EUR tek mjetet pensionale (FKPKMP) nga suficiti i aktivitetëve investuese.

21 PALËT E NDËRLIDHURA

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me entitetin, pala ka një interes në entitet që i jep një ndikim domethënës mbi entitetin, pala ka kontroll të përbashkët mbi entitetin, pala është një bashkëpunëtor ose pala është një anëtar i personelit kryesor të menaxhmentit i entitetit ose shoqërisë mëmë të saj.

FKPKOP menaxhon dhe ka kontroll të plotë mbi investimet e FKPKMP, gjegjësisht mjetet pensionale. Transaksionet ndërmjet të dyjave kanë të bëjnë me (a) financimin e FKPKOP nga tarifat e ngarkuara mbi mjetet pensionale siç përshkruhet në Shënimin 13, përshtatur për diferencën (pozitive ose negative) ndërmjet vlerës së njësisive të tërhequra si pasojë e refondimeve dhe vlerës nominale të kontributeve të refunduara, siç përshkruhet në Shënimin 14; si dhe (b) suficitit të kthyer në FKPKMP nga FKPKOP, siç përshkruhet në Shënimin 20.

Anëtarët e Bordit Drejtues (a) marrin kompensime mujore përmes honorareve siç aprovohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me rastin e miratimit të tarifës investuese dhe asaj operacionale që ngarkohen mbi fondin; dhe (b) i kanë kontributet e detyrueshme pensionale që paguhen për ta. Transaksionet për të theksuarat, për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, janë shpalosur në Shënimin 18 të këtyre pasqyrave financiare.

Personeli kryesor i menaxhmentit merr paga mujore të përcaktuara nga Bordi Drejtues, dhe kanë kontribute të detyrueshme pensionale dhe barazim të kontributeve vullnetare që paguhen për ta. Varësisht rastit, ata mund të shpërblehen me bonus të bazuar në performancë, i cili është i kufizuar në maksimalen e një page bazë mujore. Transaksionet për të mësipërmet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 ishin 248,209 EUR (2024: 247,672 EUR). Nga totali për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, pagat ishin 224,575 EUR; kontributet pensionale të punëdhënësit 18,210 EUR; dhe shpërblimet, mëditjet dhe shtesat e tjera në vlerë 5,424 EUR (2024: përkatësisht 209,958 EUR; 14,788 EUR; dhe 22,926 EUR).

22 NGJARJET PAS PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

Pas 31 dhjetorit 2025, nuk ka ngjarje të tjera të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalosje të mëtejshme në këto pasqyra financiare.

Pas datës së raportimit, menaxhmenti ka vlerësuar ngjarjet dhe transaksionet që kanë ndodhur pas periudhës së raportimit deri në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare. Gjatë kësaj periudhe, zhvillimet gjeopolitike dhe pasiguritë e vazhdueshme ekonomike në tregjet globale kanë vazhduar të evoluojnë.

Menaxhmenti ka vlerësuar ndikimin e mundshëm të këtyre zhvillimeve në operacionet, pozicionin financiar, likuiditetin dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të FKPKOP. Bazuar në informacionin aktualisht të disponueshëm, FKPKOP nuk ka ekspozim të drejtpërdrejtë të konsiderueshëm ndaj rajoneve të prekura dhe menaxhmenti beson se këto zhvillime nuk kanë një ndikim material në pozicionin financiar ose rezultatet e operacioneve të FKPKOP që nga data e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.

Menaxhmenti do të vazhdojë të monitorojë këto zhvillime dhe të vlerësojë çdo ndikim të mundshëm në të ardhmen në operacionet e FKPKOP dhe performancën e saj financiare. Përveç çështjeve të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka identifikuar ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullim ose zbulim në këto pasqyra financiare.